



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 3940/prot.

Datë 01/10/2019

UDHËZIM

Nr. 673, Datë 02/10/2019

PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT
TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS NË OSHPKSH, SPITALET
RAJONALE/BASHKIAKË DHE NJVKSH

Në imbeshtetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe Vendimit te Këshillit te Ministrave Nr. 419, datë 4.7.2018 "Për kriimin, mbyrrin e organizimit dhe të funksionimit të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor".

UDHËZIMI

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim rregullon procedurat per pubesimin e punonjësve specialist deri titular institucioni në drejtoren qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (në vazhdim DQOSHKS), drejtore të rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (në vazhdim DRQOSHKS), në Njësitet Vendore të Kujdesit Shëndetësor (në vijim NJVKSID) si dhe në administratën e spitaletëve rajonale e bashkiakë.
2. Marrëdhjetet e punës së nepunonjësve të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor tregullohen në bazu të dispozitave të Kosit të Pandës.
3. Rekrutimi i punonjësve bëhet nëpërmjet procedurave të konkuriimit të hapur mbi bazën e meritës, barazisë, profesionalizmit dhe mosdiskriminimit.
4. Emërimi dhe fitimi i drejtoreve të përgjithshëm, zëvëndësrejtoreve të OSHPKSH dhe drejtoreve të DRQOSHKS bëhet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë. Drejtoret në Drejtoren Qendrore të OSHPKSH, emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm, me miratimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Personeli tjeter brenda Drejtorisë Qendrore të OSHPKSH emërohet dhe fitohet nga drejtori i Përgjithshëm i OSHPKSH, bazuar në procedurat standarde të rekrutimit.
5. Punonjësit nga drejtori drejtore deri specialist në DRQOSHKS emërohen dhe fitohen nga drejtori i DRQOSHKS, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të OSHPKSH.
6. Drejtoret dhe nëndrejtoret e spitaletëve rajonale emërohen dhe fitohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë. Punonjësit e tjere nga specialisti deri shef shërbimi emërohen nga drejtori i spitalit pasi merr miratim për hapjen e procedurës nga drejtori i DRQOSHKS.
7. Drejtoret dhe nëndrejtoret e spitaletëve bashkiakë propozohen nga drejtori i Drejtorisë Rajonale të OSHPKSH dhe emërohen e fitohen nga drejtori i përgjithshëm i OSHPKSH. Punonjësit e tjere nga specialisti deri shef shërbimi emërohen nga drejtori i spitalit pasi merr miratim për hapjen e procedurës nga drejtori i Drejtorisë Rajonale të OSHPKSH.

- 8. Drejtorët e Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor emërohen dhe lironen nga drejtori i drejtorisë Rajonale të OSHKSH, pasi merr miratim nga drejtori i përgjithshëm i OSHKSH. Për pozicione e tjera të NJVKSH, për të cilat kërkohet arsim i lartë, emërimi dhe lirimi bëhet nga titullari i NJVKSH pasi merr miratim nga drejtori i drejtorisë Rajonale të OSHKSH.
- 9. Punonjësit mbështetës të institucionit (shofer, punëtor ej) emërohen dhe lironen nga titullari i institucionit, bazuar në dispozitat e Kodit të Punës.

KREU II

SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS DHE APLIKIMI

- Institucionet shëndetësore publike në vërsi të OSHKSH-së identifikojnë vendet e lira të punës që krijohen dhe raportojnë sipas vërsisë hierarkike pranë DROSHKSH, DQOSHKSH ose MSHMS.
- Shpallja e vendeve vakant bëhet në faqen zyrtare të DQOSHKSH, për pozicionet që janë emërtësë e ministrit dhe në faqen zyrtare të MSHMS. Gjithashtu shpallja bëhet dhe në faqen e internetit të institucionit, në rast se kanë të tillë.
- Shpallja përmban kushtet dhe kriteret që duhet të plotesojë kandidati për pranim, fushën e njohurive, dokumentet që duhet të dorëzohen, asfatin e dorëzimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe mënyrën e komunikimit të vlerësimit.

KREU III

VLERËSIMI I KANDIDATËVE

- Kandidatët do të vlerësohen për dosjen e tyre (diplomën, gjuhën e huaj, përvojën në profesion, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën), testim me shkrim si dhe për intervisten e strukturuar me gojë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 100 pikë, përkatësisht:
 - deri në 30 pikë vlerësimi i dosjes;
 - deri në 30 pikë vlerësimi me shkrim;
 - deri në 40 pikë vlerësimi i intervistës me gojë.
- Skema e vlerësimit të dosjes së kandidatëve, përcaktohet në shtojcën 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

KREU IV

KOMISIONI I VLERËSIMIT

- Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga tre anëtarë dhe sipas autoritetit që bën emërimin, miratohet si më poshtë:
 - Për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të OSHKSH, drejtorit të DROSHKSH dhe drejtorëve të spitaleve rajonale, komisioni ngrihet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.
 - Për emërimin e nëndrejtorit të spitaleve rajonale, drejtorit dhe nëndrejtorit të spitaleve bashkiak komisioni ngrihet nga DQOSHKSH, një përfaqësues do të jetë nga DROSHKSH.
 - Për emërimin e punonjësve në DQOSHKSH, komisioni krijohet nga drejtori i përgjithshëm i OSHKSH.
 - Për emërimin e punonjësve në DROSHKSH, komisioni krijohet nga drejtori i DROSHKSH.
 - Për emërimet në pozicionin shef shërbimi dhe pozicionet e tjera të administratës në spitalet rajonal/bashkiak, komisioni krijohet nga DROSHKSH, kryetar i komisionit është titullari i spitalit rajonale/bashkiak.
 - Për emërimin e drejtorit në NJVKSH, komisioni krijohet nga DROSHKSH, një përfaqësues të jetë nga DQOSHKSH.

g) Për pozicionet e punës në NJVKSH, për të cilat kërkohet arsim i lartë, komisioni krijohet nga DROSHKSH, kryetar i komisionit është titullari i NJVKSH.

2. Komisioni kryen detyrat sa më poshtë:
 - a) administron dosjet e aplikantëve;
 - b) vlerëson dokumentacionin e dosjes së çdo kandidati sipas kritereve të vlerësimit të përcaktuara në këtë udhëzim;
 - c) përgatit pyetjet me slakrim;
 - d) bën intervistimin e kandidatëve;
 - e) bën njohimin e kandidatëve për pikët e vlerësimit;
 - f) dërgon procesverbalin dhe materialet e tjera të konkurrimit pranë njësisë së burimeve njerëzore;
 - g) dërgon tek autoriteti përgjegjës për emërimin, emrin e kandidatit fitues dhe një kopje të procesverbalit.
2. Dokumentacioni ruket pranë njësie së burimeve njerëzore.

KREU V MASA DISIPLINORE DHE LARGIMI NGA PUNA

1. Procedura disiplinore ndaj punonjësit fillojnë nga drejtori/titullari i institucionit ku është i punësuar punonjësi.
2. Shkeljet disiplinore, si megjoll përcaktuohen ne kontraten individuale të punës si dhe në aktet të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Procedura disiplinore duhet të garantojë të drejtën e punonjësit për tu njotuar lidhur me fillimin e procedurit, të drejtën për tu dëgjuar, për të paraqitur prova, si dhe të drejtën për tu ankuar ndaj vendimit përfindimtar.
4. Punonjësi mund të pezullohet nga puna per shkak të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
5. Në rastet kur jepet masa disiplinore largimi nga puna ndaj punonjësit, nga titullari i institucionit, ky vendim i dërgohet organit që ka autoritetin përsëjertjen e aktit të brimit

Duhbezimi nr. 583, datë 31.07.2019 "Për procedurat e punësimit të punonjësve të administratës në OSHKSH, spitalet rajonale/bashkiake dhe NJVKSH, shfingjohet

Ky duhbezim hyr në fuqi pas banimit në fletoren zyrtare.

MINISTËR

Ogerta Manastirliq

SHTOJCA 1

Kriteret e vlerësimit të dosjes për kandidatët:

| Nr. | Treguesit dhe kriteret | Pikët |
|-----|---|-------------|
| 1. | Përvojë punë në profesion (një pikë për çdo vit pune, deri në 10 vite experience pune) | 1-10 pikë |
| 2. | Nota mesatare e studimeve të larta, Vlerësimi bëhet sipas kësaj skemë: Nota mesatare (e thjeshtë) 5.00 - 6.00 = 2 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 6.01 - 7.00 = 4 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 7.01 - 8.00 = 6 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 8.01 - 9.00 = 8 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 9.01 - 10.00 = 10 pikë | 1 - 10 pikë |
| 3. | Dëshmi të njohjes së gjuhës/vet ë huaja, maksimumi 4 pikë: Gjuhë e huaj e mbrojtur = 2 pikë | 0 - 4 pikë |
| 4. | Studime shtesë deri - 4 pikë; Master profesional - 1 pikë, Master shkencor - 2 pikë; Diplomë shtesë - 4 pikë | 0- 4 pikë |
| 5. | Trajnimë dhe dëshmi të tjera kualifikimesh që lidhen me fushën- maksimumi 2 pikë: a. trajnimë dhe kualifikime me kohëzgjatje dy javë deri në tre muaj - 1 pikë; b. kualifikime nga 3 muaj e më shumë- 2 pikë; | 0- 2 pikë |